

Informatë për media

Çështje aktuale politike në Kosovë

16 prill 2007

Index Kosova, partner me BBSS
Gallup International është kompani
private për hulumtim të opinionit
publik, mediave dhe tregut, e
vendosur në Prishtinë, Kosovë.

Bajram Kelmendi 38, 10000
Prishtinë, Kosovë

Tel/fax: +381 38 247 977

E-mail: office@indexkosova.com


URL: <http://www.indexkosova.com>

Informatat mbi hulumtimin

- ◆ Terreni u krye prej 1-7 mars 2007
- ◆ Mostra: 1,008 respondentë shqiptarë dhe minoritete (pa serbë)
- ◆ Mostra reprezentative për popullatën e Kosovës 18+ vjeçare
- ◆ Intervistë 22 minutëshe ballë-për-ballë, në shtëpi të respondentit
- ◆ Çdo e pesta intervistë e kontrolluar në terren
- ◆ Margjina e gabimit = $\pm 3.1\%$


Problemi më i rëndësishëm në Kosovë

- Me përfundimin e bisedimeve për statusin e Kosovës në Vjenë dhe me vendosjen e kësaj çështjeje në agjendën botërore, edhe vëmendja e opinionit publik në Kosovë kthehet kah statusi politik i Kosovës si problem kryesor, duke lënë papunësinë dhe çështjet tjera si probleme më pak të rëndësishme për momentin.




Prioritetet kryesore pas zgjidhjes së statusit

- ◆ Qytetarët e Kosovës besojnë se prioriteti më i rëndësishëm për udhëheqësinë e Kosovës pas zgjidhjes së statusit politik të Kosovës është sundimi i ligjit. Qytetarët gjithashtu do të dëshironin ta shohin çështjen e shëndetësisë, arsimit dhe energjisë si prioritete të tjera për t'u adresuar pas zgjidhjes së statusit politik të Kosovës.



Besimi në institucione


- Edhe pse TMK-ja dhe SHPK-ja mbesin institucionet që më së shumti gëzojnë besim në mesin e qytetarëve, ky besim ka vazhduar trendin e rënies nga viti i kaluar. Rënia e besimit ka vazhduar edhe për Policinë e UNMIK-ut dhe LDK-në, ndërsa ka filluar të kthehet besimi në Ekipin negociator, PDK-në dhe AAK-në. Lëvizja Vetëvendosje gëzon më së paku besimin e qytetarëve.



Shenim: Index-i i besimit ne institucione - prej (-2) deri ne (+2)

Përkrahja e liderëve dhe personaliteteve

- ◆ Përkundër rënies së vogël në përkrahje, Kryeministri Çeku dhe Presidenti Sejdiu janë liderët më të përkrahur në skenën politike të Kosovës, bashkë me ish-kryeministrin Haradinaj. Përderisa përkrahja ndaj liderëve si Daci, Pacolli dhe kryeparlamentari Berisha ka rënë, krerët e opozitës aktuale, Taçi e Surroi kanë shënuar ngritje të dukshme në përkrahje.



Shenim: Index-i i përkrahjes së lidereve - prej (-2) deri në (+2)

Preferencat votuese

- ◆ Pas ndarjes së LDK-së dhe paraqitjes së LDD-së së Dacit dhe AKR-së së Pacollit në skenë, kjo skenë politike e Kosovës duket e përçarë si asnjëherë më parë.

